

Nr.Prot. 070/B/18

**VENDIMI Nr. 1287****Për****Përcaktimin e ndërmarrjes IPKO Telecommunications LLC****si****“Ofrues me Fuqi të ndjeshme në Tregun e qasjes me shumicë brezgjere”**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 04/L-109 për Komunikime Elektronike, neni 1, neni 10 paragrafi 5), neni 30, neni 31, paragrafi 1), paragrafi 3.3) dhe paragrafi 4.2) dhe 4.3) , neni 32, neni 33, neni 34, neni 35, neni 36, neni 37, neni 40 dhe neni 79 paragrafi 1 dhe 2) (tutje referuar si; Ligji);, Rregullores Nr. 27 për Analizat e Tregut, (Ref. ARKEP Nr. Prot. 039/B/14), neni 3, paragrafët 1), 3) dhe 4), neni 4, paragrafi 3.13) (tutje referuar si; Rregullorja për Analizat e Tregut), Rregulloren për Sigurimin e Qasjes, Nr.Prot.012/B/11 (tutje referuar si - Rregullorja e Qasjes); Rregullorja për Interkoneksion, Nr.Prot.033/B/11; Rregulloren për Bashkë-shfrytëzimin e plotë dhe të përbashkët të lakut dhe nën-lakut lokal Nr. Prot. 024/B/11; Direktivës 2002/21/EC të Parlamentit dhe Këshillit Evropian të datës 7 Mars 2002 për Rrjetat dhe Shërbimet e Komunikimeve Elektronike (Direktiva Kornizë), Rekomandimit të Komisionit Evropian (2003/311/EC), e ndryshuar me Direktivën 2009/140/EC, së bashku me rekomandimin (2007/879/EC) e pasuar me atë të datës; 17 Dhjetor 2007 mbi produktet dhe shërbimet relevante të tregjeve të ndjeshme me rregullimin *ex-ante*; Udhërrëfyesin e Komisionit Evropian mbi analizën e tregjeve dhe vlerësimin e fuqisë së ndjeshme në treg sipas kornizës rregullatore për rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike (2002/C 165/03); Vendimit Nr. 950 për Analizën e tregjeve të Analiza e Tregjeve të Qasje me shumice brezgjere dhe Qasja me shumicë bashk-shfrytëzim - LLU (duke përfshirë qasjen e ndarë) në laqet metalike dhe nën-laqet me qëllim ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike’ dhe Përcaktimi i Operatorit me Fuqi të Ndjeshme në Treg’ të datës; 15 Mars 2017, Nr. Prot. 017/B/17, Vendimet: Nr. 1033 Nr. Prot. 050/B/17,1061 Nr. Prot. 061/B/17 dhe 1168 Nr. Prot. 013/B/18; Raportit mbi Analizën e Tregut të Analiza e Tregjeve të Qasje me shumice brezgjere dhe Qasja me shumicë bashk-shfrytëzim - LLU (duke përfshirë qasjen e ndarë) në laqet metalike dhe nën-laqet me qëllim ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike’ dhe Përcaktimi i Operatorit me Fuqi të Ndjeshme në Treg’ (tutje referuar si - Raporti); në përputhje me dispozitat e neni 13 paragrafi 1 dhe 5 i Statutit të Autoritetit Rregullator për Komunikime Elektronike dhe Postare (ARKEP), Bordi i ARKEP i përbërë nga,

- 1) z. Kreshnik Gashi Kryetar i Bordit
- 2) z. Nijazi Ademaj Anëtar i Bordit
- 3) z. Hazir Hajdari Anëtar i Bordit
- 4) z. Bahri Anadolli Anëtar i Bordit
- 5) z. Shqiprim Pula Anëtar i Bordit

në mbledhjen e 33 të Bordit të mbajtur më datë 10 dhjetor 2018, bazuar në shqyrtimin e materialeve dhe Raportit për analizat e tregut, i përgatitur nga Departamenti për Komunikime Elektronike, vendosi si më poshtë:

## V E N D I M

I. **IPKO Telecommunications LLC** përcaktohet të ketë fuqi të ndjeshme në tregun e “**Qasjes me shumicë Brezgjërë**”.

II. **IPKO Telecommunications LLC** i përcaktuar si Ofrues me Fuqi të ndjeshme në Treg detyrohet të zbatojë detyrimet e përcaktuara në bazë të Ligjit dhe Rregullores për Analiza të tregut, neni 6, si në vijim:

1. Detyrimi i Qasjes;
2. Detyrimi për mos-diskriminim;
3. Detyrimi i Transparencës;
4. Detyrimi për Kontrollin e Çmimeve.

III. Detyrimet e përcaktuara në pikën II të këtij vendimi përfshijnë:

1. **Detyrimi i Qasjes** duhet të ofrohet në përputhje të plotë me nenin 36 dhe 37 të Ligjit dhe nenit 6.3 të Rregullores për analiza të tregut. **IPKO Telecommunications LLC** duhet të ofroj qasje me shumicë brezgjërë sipas kushteve dhe procedurave të miratuara nga ARKEP: Rregulloren për Qasje dhe Rregulloren për interkoneksion . Përderisa ofron qasje me shumice Broadband, **IPKO Telecommunications LLC** duhet të:

- 1.1. ofroj qasje në elemente të veçanta të rrjetit dhe/ose objekteve që janë të nevojshme për të marrë dhe përdorur qasje me shumice brezgjërë;
- 1.2. negociojë në mirëbesim me ndërmarrjet që kërkojnë qasje me shumicë brezgjërë;
- 1.3. mos tërheqë qasjen tashmë të dhënë për objekte/pajisje;
- 1.4. ofrojë qasje të hapur në interfejsset teknike, protokollet ose teknologjitë e tjera kyçe që janë të pazëvendësueshme për ndërveprimin e shërbimeve;
- 1.5. ofroj ko-lokim/“co-location” ose forma të tjera të ndarjes (shfrytëzimit të përbashkët - sharing) së elementeve të infrastrukturës së komunikimeve elektronike;
- 1.6. ofrojë qasje në sistemet operacionale mbështetëse ose sistemet tjera softuerike të ngjashme, të nevojshme për të siguruar konkurrencë të drejtë në ofrimin e qasje me shumicë brezgjërë;

- 1.7. mund të refuzojë të ofrojë, në mënyrë të njëanshme të suspendojë ose të ndërpresë qasjen vetëm në rast se veprimet e tilla bazohen në kritere objektive, duke përfshirë jo-fizibilitetin teknik ose nevojën për të siguruar integritetin e rrjetit.
2. **Detyrimi për mos-diskriminim** duhet të ofrohet në përputhje të plotë me nenin 33 të Ligjit dhe nenit 6.3 të Rregullores për analiza të tregut. **IPKO Telecommunications LLC**. nuk duhet t'i diskriminojë përfituesit e qasjes me shumicë brezgjërë ndaj përfituesve tjerë dhe, në veçanti, të aplikojë kushte ekuivalente në rrethana ekuivalente për ndërmarrjet tjera që ofrojnë shërbime ekuivalente, dhe tu ofroj shërbime dhe informata të tjerëve nën kushte të njëjta dhe të së njëjtës cilësi që ajo ofron në shërbimet e saj ose ato të njërive apo filialeve të saja.
3. **Detyrimi i Transparencës** duhet të ofrohet në përputhje të plotë me nenin 34 të Ligjit, dhe nenit 6.3 të rregullores për analizat e tregut **IPKO Telecommunications LLC** sa i përket produkteve të me shumicë brezgjërë duhet që;
- 3.1. brenda 3 muajve nga data e miratimit të këtij vendimi, të publikoj ofertën referente sipas Rregullores për Qasje dhe Rregullores për interkoneksion;
- 3.2. t'i sigurojë ndërmarrjeve, që kërkojnë interkoneksion të gjitha informacionet e nevojshme për t'u ndërlidhur;
- 3.3. Përderisa është duke ofruar shërbimet e qasjes brezgjër me shumicë, **IPKO Telecommunications LLC** duhet që 36 muaj përpara t'i njoftojë klientët rreth vendimit për tërheqjen (withdraw) e pikave të qasjes që aktualisht janë në përdorim. Në rast se **IPKO Telecommunications LLC** ofron qasje plotësisht ekuivalente (në aspektin e cilësisë, funksionalitetit dhe çmimeve) në të njëjtën lokacion gjeografik **IPKO Telecommunications LLC**. duhet t'i informojë klientët e qasjes me shumicë brezgjërë rreth vendimit për tërheqjen e pikave të tilla të qasjes 12 muaj para. Së bashku me njoftimin e tillë, **IPKO Telecommunications LLC** duhet t'u ofroj klientëve të saj një propozim alternativ të qasjes, i cili duhet të siguroj qasje të plotë ekuivalente të referuar si më lartë dhe ofrimin e pandërprerë (me përjashtim të mirëmbajtjes gjatë procesit të migrimit) të shërbimeve për përdoruesit fundor. Nëse ofruesi i shërbimit nuk ka mundësi teknike që të siguroj qasje të plotë ekuivalente të klientit të qasjes bitstream, siç është referuar në këtë paragraf, atëherë **IPKO Telecommunications LLC** duhet t'i kompensoj klientit të bitstream investimet e pakthyera, për shkak të ndërprerjes së ofrimit të qasjes në fjalë.
4. **Detyrimi për kontrollin e çmimeve** duhet të ofrohet në përputhje me nenin 40 të Ligjit dhe nenit 6.1 të Rregullores për analizat e tregut. **IPKO Telecommunications LLC**. sa i përket ofrimit të qasjes me shumicë Broadband duhet të siguroj që:
- 4.1. Çmimet e qasjes me shumicë brezgjërë të përcaktohen duke përdorur modelin "Retail minus". **IPKO Telecommunications LLC** duhet të negocioj në mirëbesim me

kërkuesit e qasjes për të siguruar që çmimet e qasjes me shumicë brezgjërë janë të vendosura në nivel të arsyeshëm, të cilat nuk krijojnë shtrembërime të konkurrencës. Ne rast se ARKEP me kërkesë të palës së interesuar apo me vetiniciative konstaton se çmimet e qasjes me shumicë Broadband nuk janë të arsyeshme, mund t'i kërkojë operatorit **IPKO Telecommunications LLC** sh.a. që të ndryshoj këto çmime, duke përdorur mënyra të tjera (p.sh. modelet “bottom-up”, “benchmarking”, etj.);

4.2. Në çmimet e qasjes me shumicë brezgjërë nuk duhet të përfshihen shërbimet/objektet, të cilat nuk janë të nevojshme për qasjes me shumicë brezgjërë. Sa i përket qasjes me shumicë brezgjërë të gjitha shërbimet shtese që nevojiten për sigurimin e qasjes me shumicë brezgjërë janë të rregulluara në të njëjtën mënyrë si qasjes me shumicë brezgjërë dhe trajtohen si shërbime përcjellëse.

IV. Këtij vendimi i bashkëngjitet Raporti për “Analizat e tregjeve”.

V. Ky vendim është përfundimtar dhe hynë në fuqi ditën e nënshkrimit.

## ARSYETIM

Në bazë të nenit 10 paragrafi 5) i Ligjit përcaktohe se “Miraton vendimet në lidhje me përcaktimin e tregjeve përkatëse, kryen analizat e tregut dhe imponimin, si dhe tërheqjen e obligimeve të rregullatorit tek operatorët me fuqi të ndjeshme tregu”.

Në bazë të nenit 30 paragrafi 1 i Ligjit “Ndërmarrësi do të konsiderohet që ka fuqi të ndjeshme tregu (FNT) nëse ai, ose bashkë me të tjerët ka një pozitë ekuivalente mbizotërimi, pra një pozitë të forcës ekonomike që i jep fuqi që të veprojë në nivel të konsiderueshëm në mënyrë të pavarur nga konkurrentët, klientët dhe shfrytëzuesit fundorë”, Për me tepër paragrafi 2 i këtij neni përcakton se “Aty ku ndërmarrësi ka FNT në një treg relevant, gjithashtu mund të mendohet që ka FNT në një treg të lidhur ngushtë me të (tregu tjetër), nëse lidhjet në mes dy tregjeve janë të tilla që të lejojnë që fuqia e tregut që e ka në një treg të ndikojë në tregun tjetër, duke përforcuar fuqinë në treg të ndërmarrësit. Prandaj, detyrimet që kanë për qëllim parandalimin e ndikimit të tillë mund të zbatohen në tregun tjetër”.

Neni 30 paragrafi 3 përcakton se “Ndërmarrësi do të identifikohet që ka FNT atëherë kur përcaktohet me vendim të Autoritetit, bazuar në një analizë të tregut, dhe do të konsiderohet si e tillë derisa Autoriteti përcakton me vendim të saj, bazuar në një analizë tjetër të tregut që ndërmarrësi nuk ka FNT”.

Kurse neni 32 i Ligjit përcakton se Autoriteti ka të drejtë të imponoj detyrime për ndërmarrësit që kanë FTN në një treg relevant.

Bazuar në Raportin e Analizës së Tregut rezulton se IPKO Telecommunications LLC:

- ka pjesëmarrje 40% në tregun e ofrimi të shërbimeve të qasjes në internet per përdoruesit fundor dhe konkluzionet shtesë që argumentohen në raport si në vijim:
- posedon infrastrukturë e cila nuk është lehtësisht e duplikueshme;
- operator vertikalisht i integruar me lloje të ndryshme të produkteve, ka përparësi të qarta konkurruese mbi konkurrentët e saj;
- është operatori me i madh i rrjetit te telefonisë fikse, ka përparësitë e aktivitetit te ekonomisë se shkalles dhe fushëveprimit për shërbimet qasjes me shumicë brezgjere krahasuar me operatorët alternativë dhe atyre potencialë.

Duke pas parasysh atë që u tha më lartë si dhe faktin se Korniza rregullatore të BE-së, e cila është transpozuar në Ligjin për Komunikimet Elektronike, përcakton se detyrimet rregullatore duhet të zgjidhen duke pasur parasysh parimin e proporcionalitetit dhe duhet të jenë më pak të rënda dhe të përshtatshme për këtë qëllim (grupi minimal i detyrimeve që do të ishin në gjendje t'i zgjidhnin problemet e identifikuar të konkurrencës). Pra rregullimi duhet të jetë minimal i domosdoshëm, i bazuar në parimet themelore për rregullimin e aktiviteteve të komunikimeve elektronike.

Andaj, është vendosur sikurse në dispozitiv të këtij vendimi.

#### **Këshilla Juridike:**

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit.

**Prishtinë, 26/12/2018**

**Autoriteti Rregullator i Komunikimeve Elektronike**

**Kreshnik Gashi  
Kryetar i Bordit**

#### **Aktvendimi i dërgohet:**

- Operatorëve të Autorizuar të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike;
- Autoritetit Kosovar të Konkurrencës;
- Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik;
- Arkivit të ARKEP-it.